



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 12.01.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Drejtuar: Shoqërisë “SI.SI-AL sh.p.k” shpk me NUIS K72117030P me adresë:
Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81382-12-07-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim i sinjalistikës rrugore, Rruga e Durrësit” afati: Brenda 40 (dyzet) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme
☐

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 119, Date 14.12.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “R.S.M Company” shpk me NUIS L04803001U dhe me ofertë 3.801.500 (tre milion e tetëqind e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “SI.SI-AL sh.p.k” shpk me NUIS K72117030P me ofertë 5.027.880 (pesë milion e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “R.S.M Company” shpk me NUIS L04803001U
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk përmbush pikën 1, shkronja b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se “Ofertuesi duhet të dorëzojë: b) Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1”.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik dhe rezulton se janë paraqitur dy “Deklarata për paraqitje Oferte të Pavarur” (Shtojca 2/1), përkatësisht nga:
 - 1- Shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, degë e shoqërisë së huaj
 - 2- Shoqëria “RSM Company” sh.p.k

Në të dyja deklaratat e paraqitura **nuk është plotësuar** rubrika 6, ku ofertuesi duhet të klikonte një nga alternativat e dhëna, pikën a) ose pikën b).

Referuar sa më sipër, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar rubrikën 6 të shtojcës 2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” pjesë e dokumentave të tenderit në kundërshtim me parashikimin e pikës 1.1, të Seksionit 1, “Hartimi i ofertës” të dokumentave standarte të tenderit ku parashikohet se “*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme*”.

➤ Nuk përmbush pikën 2.3.1, të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “*Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

1. *Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 2.236.176 (dy milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. *Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

OSE

b. *Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik dhe rezulton se ai ka paraqitur disa fatura tatimore shitje si mëposhtë vijon:

1. Fatura nr.159, datë 04.08.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin , shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 1.666.666 lekë pa tvsh.
2. Fatura nr.31, datë 10.07.2019 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.
3. Fatura nr.155, datë 23.06.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.
4. Fatura nr.94, datë 04.06.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.
5. Fatura nr.90, datë 13.04.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.
6. Fatura nr.81, datë 13.02.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.

7. Fatura nr.79, datë 03.02.2020 lëshuar nga Shitësi, shoqëria ESSA Industry sh.p.k për Blerësin, shoqërinë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”, në vlerën 833.333 lekë pa tvsh.

Komisioni konstatoi se në faturat e lëshuara, operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” figuron në rolin e blerësit, që do të thotë se nëpërmjet tyre operatori nuk fakton se ka kryer furnizime por thjesht ka marrë furnizim nga shoqëria “ESSA Industry” sh.p.k.

Ndodhur në këto kushte, operatori ekonomik, nëpërmjet faturave të sipërcituara nuk provon dot përvojën e mëparshme, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për kryerjen e furnizimeve nga ana e tij.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5, të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrën e mallit objekt prokurimi, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e tenderit. Mosparaqitja e saj përbën kusht për skualifikim”*.

Nga verifikimi i mostrës së dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se ajo nuk është realizuar në përputhje me skicën e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor pasi mungon një nga elementët e brendshëm të kompozimit, përkatësisht elementi i pozicionuar në njërin nga këndet e sipërme me përmasë 220 mm.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Operatori ekonomik “**SI.SI-AL sh.p.k**” shpk me NUIS K72117030P, me adresë Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë dhe me ofertë ekonomike **5.027.880** (pesë milion e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 23.12.2020.

Ankesa: Ka me datë: 29.12.2020.

Ka marrë përgjigje me datë: 30.12.2020